



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:241606  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05747761

CA.nr.1752/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.S nga V....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.M, avokat në Vushtrri, kundër të paditurit J.S nga V....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson L.P, avokat nga Vushtrria, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.1083/2023, i datës 15.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit J.S nga V....., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.1083/2023, i datës 15.01.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

*Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.1083/2023, i datës 15.01.2024, ka vendosur si në vijim: “ I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.S nga V.....  
II. VERTETOHET se i padituri J.S, nga V....., me datat 28.10.2023, 29.10.2023 dhe 07.11.2023 e ka penguar paditësin A.S në posedimin e qetë të ngastrës kadastrale P-..... ZK V....., në sipërfaqe prej 40 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “V.....”, e evidentuar në certifikatën e pronësisë me numër të lëndës ....., e datës 03.01.2024, ashtu që në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër vullnetit të paditësit, ka vepruar kundërligjshëm duke e mbyllur lokalin me zinxhir*

*dhe dry si dhe njëkohësisht ia dëmton cilindrin e derës së hyrjes së lokalit dhe dy cilindra të mrezhës mbrojtëse duke e mbushur me material të panjohur e që kështu ia pamundëson hapjen e lokalit me çelës.*

*III. URDHEROHET i padituri J.S që në të ardhmen të përmbahet nga çfarëdo veprimi të kundërligjshëm që kanë qëllim pengimin në posedim në pronën lëndore.*

*IV. OBLIGOHET i padituri që t'ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës, dhe të për përpilimin e padisë shumen prej 51.00 euro, për ekspertizën gjeodete, shumën prej 193.52 euro, për përfaqësimin nga avokati në 3 seanca shumën prej nga 135.00 euro për secilën seancë, apo shumën e përgjithshme për të gjitha shpenzimet në lartësi prej 1,138.56 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi”.*

Kundër këtij aktvendimi i padituri, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vlerësimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim gjykatës së shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Pala paditëse ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurit, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore, me propozim që ankesa e të paditurit të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimit e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 08.11.2023, ka parashtruar padi ndaj të paditurit për shkak të pengimit në posedim, duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, duke e vërtetuar se i padituri J.S , nga V....., me datat 28.10.2023, 29.10.2023 dhe 07.11.2023 e ka penguar paditësin A.S në posedimin e qetë të ngastrës kadastrale P-..... ZK V....., në sipërfaqe prej 40 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “V.....”, e evidentuar në certifikatën e pronësisë me numër të lëndës ....., e datës 03.01.2024, ashtu që në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër vullnetit të paditësit, ka vepruar kundërligjshëm duke e mbyllur lokalin me zinxhir dhe dry si dhe njëkohësisht ia dëmton cilindrin e derës së hyrjes së lokalit dhe dy cilindra të mrezhës mbrojtëse duke e mbushur me material të panjohur e që kështu ia pamundëson hapjen e lokalit me çelës, duke e urdhëruar të paditurin që në të ardhmen të përmbahet nga çfarëdo veprimi të kundërligjshëm që kanë qëllim pengimin në posedim në pronën lëndore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesëpadiës së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse në shqyrtim gjyqësor, si dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktvendimin C.nr.1083/2023 i datës 15.01.2024, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilin ka vërtetuar se është shkaktuar pengim posedimi nga ana e të paditurit, më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të njëjtë.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës nga provat e administruara ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në procedurë, është provuar se paditësi ka qenë në posedimin e fundit faktik të ngastrës kadastrale lëndore, andaj e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se janë plotësuar kushtet ligjore në mënyrë kumulative. Gjykata ka theksuar se për të ekzistuar pengimi i posedimit, duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen dy kushte që personi i cili pretendon që është penguar në posedim e qetë të sendit, të ketë qenë poseduesi i fundit i atij sendi dhe që pengimi të ketë ndodhur me veprim të kundërligjshëm. Nga deklarimi i të paditurit, u vërtetua se posedues i paluajtshmërisë kontestuese që nga vitit 2006 është paditësi dhe me datën 28.10.2023, vetë i padituri ka vendosur zinxhir me dry në lokalin i cili ka qenë në posedim të paditësit dhe me datën 29.11.2023 ka vendosur zinxhir, dry dhe bravat me ngjitës, si dhe me datën 07.12.2023, ka shkuar në lokalin kontestues dhe ka tentuar që ta prish cilindrin e derës. Nga provat e administruara, gjegjësisht nga pohimet e të paditurit rrjedh se plotësohet kushti i parë se personi i cili pretendon që është penguar në posedim e qetë të sendit, duhet të ketë qenë poseduesi i fundit i atij sendi, si dhe kushti i dytë se pengimi në posedim ka ndodhur me veprim të kundërligjshëm. Andaj gjykata bazuar në nenin 111 par. 1 të LPDTS-së, vlerëson se me veprimet e të paditurit, duke vendosur zinxhir me dry në lokalin kontestues dhe duke i pamundësuar paditësit qasje në lokalin të cilin ky i fundit e ka në posedim faktik, ka kryer aktin e pengim posedimit në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që gjykata konform kësaj gjendje të vërtetuar faktike, e cila ishte në përputhje me faktet që rrjedhin nga gjendja juridike, vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar. Për vendosjen si në pikën III të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, gjykata u bazua në nenin 113 par. 2 të LPDTS-së, pasi që vërtetoi se i padituri me veprim të kundërligjshëm ka penguar paditësin në posedimin e qetë të lokalit të lartcekur, andaj të njëjtin e urdhëroi që të përmbahet nga veprimet e ngjashme apo të njëjta, me të cilat mund të pengoj paditësin në posedimin e lirë dhe të qetë të lokalit në fjalë.

Gjykata e shkallës së parë aktvendimin e atakuar e ka marrë në pajtim me dispozitat e nenit 103, 107 paragrafi 1, 111 paragrafi 1 dhe neni 113 paragrafi 1 dh 2 të LPDTS e lidhur me nenin 480 të LPK-së ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në pajtim me nenet 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, përfundim e gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së, në të cilat shikon kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa dhe gjykata e shkallës së parë në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht nenin 103 dhe neni 113 paragrafi 1 dhe 2 të LPDTS.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n) të LPK-së. Dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i qartë dhe në pajtim me arsyetimin, gjykata ka paraqitur arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me posedimin dhe pretendimet e paditësit për aktin e pengimit të posedimit. Në kontestet e pengimit të posedimit gjykata është e obliguar të provoj faktet lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara është vërtetuar se në rastin konkret paditësi

është posedues i fundit i paluajtshmërisë lëndore dhe është vërtetuar akti i pengim posedimit në paluajtshmërinë lëndore, në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Poashtu aktgjykimi përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitën e nenit 160 par. 1 të LPK-së, arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar, si dhe tregon se cilat dispozita materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes për kërkesat e palëve, e konform paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike nga provat e administruara, ku është provuar se paditësi ka qenë në posedimin e fundit faktik të lokalit lëndor, gjë që u vërtetua edhe nga pohimet e të paditurit se posedues i paluajtshmërisë kontestuese që nga vitit 2006 është paditësi dhe me datën 28.10.2023, vetë i padituri ka vendosur zinxhir me dry në lokalit i cili ka qenë në posedim të paditësit dhe me datën 29.11.2023 ka vendosur zinxhir, dry dhe bravat me ngjitës, si dhe me datën 07.12.2023, ka shkuar në lokalit kontestues dhe ka tentuar që ta prish cilindrin e derës. Nga provat e administruara, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore në mënyrë kumulative për faktin se posedues i fundit i lokalit kontestues ka qenë paditësi, ndërsa i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e qetë të lokalit lëndor me veprimet e tij të kundërligjshme të përshkruara me lart, andaj drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur të paditurin e ka urdhëruar që të përmbahet nga veprimet e ngjashme apo të njëjta në të ardhmen, me të cilat mund të pengojë paditësin në posedimin e lirë dhe të qetë të lokalit në fjalë, andaj pretendimet e palës ankuese u refuzuan të pathemelta.

Sipas dispozitës së nenit 103 të LPDTS-së, parashihet se *“personi që e ushtron pushtetin faktik është posedues i drejtpërdrejtë”*, sipas nenit 111.1 të të njëjtit ligj parashihet se *“Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj”*, e sipas nenit 113 par. 1 të të njëjtit ligj parashihet se *“Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta”*, ndërsa par. 2 parasheh se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*, e që në rastin konkret paditësi ka qenë posedues i fundit i lokalit lëndor dhe se në mënyrë të kundërligjshme është penguar nga posedimi i lirë dhe i qetë i tij nga ana e të paditurit, në mënyrën e lartpërshkruar, andaj pretendimet e palës ankuese në këtë drejtim janë refuzuar të pathemelta.

Në rrethana të tilla rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me gjendjen e fundit të posedimit dhe pretendimit për aktin e posedimit, ku mbi këtë bazë nga provat e administruara ka nxjerr përfundimin e drejtë se paditësi është penguar nga

i padituri në posedimin e lirë dhe të qetë të lokalit lëndor, prandaj edhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me të drejtën materiale.

Bazuar në nenin 480 të LPK-së i cili parasheh që shqyrtimi i çështjes të padisë për shkak të pengimit të posedimit, kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfshihet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjeshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit, andaj dhe kjo gjykatë e vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka vërtetuar se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit në kohën dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar,

Gjykata e Apelit vlerëson se në pajtim me nenin 452.1 të LPK-së, është vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i vlerësoi pretendimet tjera ankimore të paditurit dhe gjen se janë të pathemelta dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë, andaj në kuptim të nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CA.nr.1752/2024, me datë 21.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Nora Bllaca-Dula, d.v.